

Data 29.06.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË PUBLIKE - Prokurim me mjete elektronike

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndertim i godines se MZSH dhe instalimet per mbrojtjen nga zjarri ne tunelin Kardhiq-Delvine”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për stacione zjarri: 45216121-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 80,252,940.88 (tetëdhjetë million e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet presje tetëdhjetë e tetë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të *Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024* Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet operative për vitin 2026-2028 (*Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026*).

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**punë të ngjashme**):

- Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
 - Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës**):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar)

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

Argumentimi teknik: Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi përvojën e mëparshme të operatorit, i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër, i cili i mbështet thjesht për t’u kualifikuar, por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit. Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori, i cili do të fitonte kontratën nuk do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi.

Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrisë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë. II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente: - Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; - Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë; - Kapacitetet financiare. **Duke qenë se pikat e licencës përfitohen si rezultat i eksperiencës dhe cilësisë, ato i përkasin vetë shoqërisë, dhe shfrytëzohen në harmoni me të gjithë komponentët që përbëjnë këtë shoqëri.**

Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kritere.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehur në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Çmimi □	pikët 60
Metodologjia □□	pikët 5
Stafi / Organizimi i Kompanisë □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periudha e garancisë të objektit □□	pikët 10

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b ,3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [60 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)*

2. Metodologjia [5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

Faktorët favorizues: Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm.

Pajisje inovative: Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit.

Metodologji punimesh: Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).*

Kontraktori duhet të përgatisë Metodologjinë e Punëve për të plotësuar kërkesat e zbatimit të projektit në kohën, sasinë dhe cilësinë e duhur. Metodologjia që ndiqet për realizimin e punimeve synon të garantojë cilësinë dhe përmbushjen me sukses të kontratës, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit.

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin **2.3** / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënës të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.*

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Standardi gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket çështjeve të impaktit në mjedis dhe social që përfshihen në punimet që do të kryhen. Operatori ekonomik duhet të ndjekë parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit duke përdorur Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si një instrument për mbrojtjen e mjedisit, duke identifikuar dhe vlerësuar efektet e mundshme direkte dhe indirekte për parandalimin e tyre.

Operatori ekonomik kryen mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet parandalimit, zbutjes dhe kompensimit të dëmeve të projekt propozimit, i cili mund të shkaktojë efekte negative të rëndësishme mbi mjedisin për shkak të madhësisë, natyrës ose zonës ku parashikohet të zbatohet.

5. Periudha e garancisë të objektit [10 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vite) [10 pikë]
Kjo, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”.

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkuara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qënë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës për vlerësimin me pikë për këto dy nënkritere duhet të vetëdeklarojë se do të kryejë edhe mirëmbajtjen rutinë gjatë periudhës së garancisë.

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkuara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP (ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në *Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024); Nenin 39, pika 6/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar)*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiros vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në *Nenin 77, pika 3 e LPP (i ndryshuar), si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur - Punë Publike - Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të *Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Gjithashtu, është përcaktuar jo më e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në *Nenin 43, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 (*Bilancet të parqiten konform parashikimit të nenit 41 Ligjit nr. 10091/2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në *Nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024), si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", (i ndryshuar), si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në Nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore"

"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:

- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021 (i ndryshuar), parashikon:

“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të Nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e

shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1/A	(Punime gërmimi në tokë)
2	NP - 2/C	(Ndërtime civile dhe industriale)
3	NP - 4/A	(Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramwai, metro, pista aeroportuale)
4	NP - 12/A	(Punime të inxhinierisë së mjedisit)
5	NS - 2/A	(Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)
6	NS - 4/A	(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)
7	NS -12/A	(Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit)
8	NS -14/A	(Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.)
9	NS -18/A	(Punime topogjeodezike)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024); Nenin 39, pika 6/a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e

mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1/A	Punime gjurmimi në tokë	Punime dheu/ gjurmimi në rrugë	0-20 milion	462,281
NP - 2/C	(Ndërtime civile dhe industriale)	Punimet totale per objektin	51-100 milion	62,643,298.44
NP - 4/A	(Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)	Punime rrugore	0-20 milion	15,750,000
NP-12-A	Punime te inxhinierise mjedisore	2 % e punimeve	0-20 milion	1,567,865.97
NS - 2/A	(Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)	Punime hidro-sanitar	0-20 milion	15,625,330.19
NS - 4/A	(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Punime për dyer dritare etj	0-20 milion	17,335,359.49

NS -12/A	(Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit)	Punime kondicionimi	0-20 milion	8,866,049.85
NS -14/A	(Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.)	Punime elektrike	0-20 milion	1,607,395.04
NS -18/A	(Punime topogjeodezike)	2 % e punimeve	0-20 milion	1,567,865.97

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi ose të kontraktojë me një shoqëri projektuese të licencuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

Nr.	Kategoria	Fusha e projektimit	Pika
1	1	PROJEKTIM URBANIST	c- Plane të detajuara vendore
2	2	PROJEKTUES ARKITEKT	a- Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike d- Projektim peizazhi, sisteme sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.)
3	3	PROJEKTUES KONSTRUKTOR	a- Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
4	4	PROJEKTUES INSTALATOR	(a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare; b- Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa j- Projektim i rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access control, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.)
5	6	PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA	a- Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore
6	8	PROJEKTUES GJEODET	a- Rilevime inxhinierike

7	9	STUDIM GJEOLIGO- INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK	a- Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate
8	11	PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.	a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Shënim: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysht VKM nr.759, datë 12.11.2014 të “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3.1 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon **stafin Teknik, të pajisur me licencë individuale në projektim**, të aftë për kryerjen e shërbimit të projektimit sipas objektit të kësaj kontrate, si më poshtë:

- **1 (një) inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Arkitekt / Urbanist**
- **1 (një) inxhinier Mekanik**
- **1 (një) inxhinier Topograf**
- **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- **1 (nje) Inxhinier Gjeolog**
- **1 (nje) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (nje) Inxhinier Elektronik**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar me VKM Nr. 545, datë 04.09.2024), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik lidhet ngushtësisht objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinierët janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3.4 Personelin kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **1 (një) inxhinier Ndërtimi Profili structure**
- **1 (një) inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) inxhinier Mekanik**
- **1 (një) inxhinier Topograf**
- **1 (nje) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- **1 (nje) Inxhinier Elektronik**

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve

të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar me VKM Nr. 545, datë 04.09.2024), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik lidhet ngushtësisht objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinierët janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) inxhinier Ndërtimi Profili structure**
- **1 (një) inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) inxhinier Mekanik**
- **1 (një) inxhinier Topograf**
- **1 (nje) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- **1 (nje) Inxhinier Elektronik**

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **38 (tridhjetë e tetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Maj 2026**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Maj 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Maj 2026**.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën,

mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **të paktën 38 persona**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (materiale, punëtori, makineri, transport) zëri i fuqisë punëtore zë rreth 20% të kostos.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë duhet të disponojë minimumi punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi - **1 (nje)** punonjës
- Teknik mekanik – **1 (nje)** punonjës
- Hidraulik – **2 (dy)** punonjës
- Elektriçist- **1(një)** punonjës
- Saldator – **1 (një)** punonjës
- Hekurkthyes – **1 (një)** punonjës
- Karpentier – **3 (tre)** punonjës
- Murator – **2 (dy)** punonjës
- Pllakashtrues – **1 (nje)** punonjës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese,

Argumentimi: Vendosja e ketij kriteri bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjin nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“, i ndryshuar; ligjin 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar; VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projekt zbatimin dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Ne nenin 39, pika 6/c)/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës. ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ne neni 4 “Perkufizime”, te ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“ i ndryshuar, nder te tjera, percaktohet : “Kualifikimi profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies te një ofrues i AFP-së, i përmbyllur me provime dhe i certifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë). “Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. “Akreditimi” është njohja formale që një institucion mund të kryejë detyrat për të cilat është licencuar. Akreditimi i një ofruesi të AFP-së është procesi i sigurimit të cilësisë së ofruesit që tregon se institucioni është i miratuar nga autoritetet përkatëse dhe që ka përmbushur standarde të paracaktuara. “Lista Kombëtare e Profesioneve” klasifikon profesionet, bazuar në llojin e punës e në kompetencat e nevojshme dhe përbëhet nga emërtimet përkatëse të profesioneve/punëve e nga përskrimet e profesioneve. Ne nenin 12 te ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“ i ndryshuar, nder te tjera, percaktohet: 1. AFP-ja ofrohet nga institucionet publike dhe private. 2.

Institucionet ofruese të AFP-së janë: a) shkollat e mesme profesionale; b) qendrat shumëfunktionale të AFP-së; c) qendrat e formimit profesional; ç) institucionet e specializuara të AFP-së për grupet e veçanta; d) shoqëritë tregtare; dh) institucionet e tjera të licencuara dhe/ose të akredituara ose individët Ne nenin 29 të ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“ i ndryshuar, nder te tjera, percaktohet: 1. Certifikata e kualifikimit profesional i lëshohet një individ, i cili i ka përmbushur standardet përkatëse të kualifikimit, pas një procesi vlerësimi formal. 2. Dokumentet e certifikimit lëshohen nga ofruesi i AFP-së. Ne nenin 7, pika 12 të VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT nder te tjera, percaktohet: 12. Zbatuesi i punimeve detyrohet të sigurojë në kantier: a) punëmarrës të aftë, të kontrolluar për shëndetin, me leje për ushtrim profesioneve të veçanta (dëshmi, leje, autorizime) nga organet e autorizuar me ligj; d) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë. Ne nenin 115, pika 1 të ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se: 1. Ndalohej drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod. Ne nenin 178, pika 5 të ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se: 5. Drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete certifikatën e aftësisë profesionale, kur ajo kërkohet. Në përcaktimin e profileve konkrete të stafit teknik punonjësve të kualifikuar, si dhe numrit të tyre, AK është bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”; VKM nr. 514, date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare të profesioneve (LKP), të rishikuar; Urdherin nr.200, date 16.05.2019 të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorikopraktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit“, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra dhe të grafikut të punimeve. • Tekniku i ndërtimit është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e murures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat për punetoret dhe ndjek ecurinë e tyre gjatë kohës së punës.. • Tekniku Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike për instalimin e sistemit ngrohje ftohje, paneleve fotovoltaike, sipas zërave të preventivit duke asistuar drejtuesin teknik. • Karpentierët janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zërave të preventivit. Bejne piketimin dhe armaturen anesore të themelit, bejne vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku të punimeve, ku punimet ku kërkohet prezenca e punonjësve karpentieri (punimet e betonit dhe b/a) është parashikuar të realizohet në muajin e dytë, si dhe tek përlogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo zëra të punimeve të parashikuara në preventiv. Duke pasur parasysh volumin e konsiderueshëm dhe grafikun

duhen min 4 punonjes te kualifikuar. • Hekurkthyesi është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve te hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve hekurkthyes eshte parashikuar te realizohet ne muajin e dyte, trete dhe te dhjete, si dhe tek perllogaritet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e hekurit jane 2736 ore, qe te kthyer ne dite jane 342 dite pune ($2736/8=342$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 16 persona. ($342/22=15.5$). Jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj). • Pllaka shtruesi është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit te pllakave sipas zërave të preventivit të punimeve. Shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dyshemeve ose mbulojnë dyshemetë, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Studiojnë projektin përkatës për sipërfaqet që do të shtrojnë; Përgatitin sipërfaqen e dyshemesë për t’u mbuluar me parket, pllaka ose materiale të tjera; Bëjnë nivelimin e sipërfaqes me material mbushës (rërë e çimento apo material i gatshëm mbushës prodhuar apopersonelat për këtë funksion); Bëjnë matjen dhe prerjen e pllakave sipas projektit; Vendosin pllakat apo materialet e tjera në dysheme sipas skicës dhe përshkrimeve të tjera, duke respektuar afatet e mpiksjes së materialeve; Montojnë pjesët e parketit etj. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, si dhe tek perllogaritet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e shtrimit te pllakave ne muajin e peste jane 1914 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 239 dite pune ($1914/8=239.2$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 16 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 15 persona. ($239/16=14.9$). Jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj). • Muratori është i nevojshëm për realizimin e punimeve te muraturës, soletave etj. sipas zërave të preventivit. Bëjnë piketimin e mureve të objektit, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt; kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve muratore eshte parashikuar te realizohet ne muajin e katert, si dhe tek perllogaritet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet murature tulle jane rreth 2770 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 346 dite pune ($2770/8=346.25$). Duke

llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 16 persona. ($346/22=15.7$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- Bojaxhiu është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, bejne stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lyerjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lyerjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lyerjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjtja, të strukturave metalike, kornizave të hekurta të ndërtesave.

Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve bojaxhinj eshte parashikuar te realizohet ne muajin e njembdhjete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e lyerjes me boje ne muajin e njembdhjete jane rreth 1355 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 169 dite pune ($1355/8=169.37$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 14 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 12 persona. ($169/14=12.07$). Jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar bojaxhinj. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).- Elektracisti është i nevojshem për realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Shqyrtojnë projektet, skicat e instalimeve elektrike dhe specifikimet përkatëse; Përcaktojnë hyrjen kryesore të rrejtit elektrik në objekt; Kryejnë shtrimin e kolonës kryesore të energjisë elektrike; Bëjnë shtrimin e tubave dhe fiksimin e tyre; Kryejnë shtrirjen e përcjellësve në tuba; Bëjnë lidhjen e telave në kutitë shpërndarëse; Kryejnë montimin e çelësave, prizave dhe të automateve etj. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet elektrike jane parashikuar te realizohen ne muajin e gjashte shtate dhe te tete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet elektrike ne muajin e gjashte jane rreth 1678 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 210 dite pune ($1678/8=209.75$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 14 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete 15 persona. ($210/14=15$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar elektriciste. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- Hidrauliku është i nevojshem për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet hidraulike jane parashikuar te realizohen ne muajin e gjashte dhe te shtate, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet ku perfshihen edhe ato hidraulike ne muajin e gjashte dhe te shtate jane rreth 2400 ore, qe te kthyer ne dite jane 300 dite pune ($2400/8=300$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 14 persona. ($300/22=13.6$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar hidraulike. Llogaritja

e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj). • Saldatori është i nevojshem për realizimin e punimeve sipas zërave të preventivit: F.v konstruksione metalike te perbera; F.v konstruksione metalike. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve saldatore eshte parashikuar te realizohet ne muajin e dyte, te trete dhe te gjashte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet per konstruksione metalike te perbera te parashikuara per tu realizuar ne muajt e trete jane 4050 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 506 dite pune ($4050/8=506.25$). Duke llogaritur qe keto punime sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 23 persona. ($506/22=23$). Jane llogaritur minimumi 2 punonjes te kualifikuar saldatore. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjes i pajisur me certifikuar **“Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

1 (një) punonjes që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores ”Për sigurine në kantier”.

1 (një) **ekspert zjarrfikës** me certifikatën përkatëse lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së / licencë për mbrojtje nga zjarri të lëshuar nga QKL,

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.8 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht,

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit Nr. 10431, datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM Nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.9 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve (*inxhinier me eksperiencë*) në objekt, i cili jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune**”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe nenit 39, pika 6/c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” e ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të përcaktojnë Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul gome-gome	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkiator për transportin e makinerive	1 copë	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit;

certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018).

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë,

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese,

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar si, fadroma, dhe (per mjetet e tjera te vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja te cilet kërkohet që drejtuesit të jenë të specializuar), kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet:*

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 Grafiku i punimeve.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), Nenin 39, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).*

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e Nenit 4, pika 38/b dhe Nenit 36, të LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), si dhe nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP (i ndryshuar). Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike do të hartohen dhe do të argumentohen për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuar nga projektuesi.

Termet e Referencës, janë pjesëe pandarë e DST

Në çdo rast nëse janë përmendur markë prodhimi ose proces i veçantë pranohen edhe ekuivalent.

Në rastin konkret, preventivi në lidhje me këtë projekt është paraprak. Vëllimet e parashikuara janë të përafërta. Pra, referuar VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Neni 39, pika b), kjo kontratë do të trajtohet si një “kontratë me çelësa në dorë”, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast, Kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.